

Gjykata Federale Zvicerane, vendosi se ndalimi i shamisë që zbatohet në disa shkolla të kantonit St. Gallen është i paligjshëm, raporton Anadolu Agency (AA).

Me këtë vendim i marrë nga gjykata, është vendosur pika e fundit në lidhje me rastin e një vajze muslimane 14 vjeçare e cila në shkollën St-Margrethen nuk është marrë në mësim për shkak se është e veshur me shami.

Drejtorja e shkollës, pohonte se shamia ishte në kundërshtim me rregullimin e veshjes në shkollë. Në vendimin e gjykatës theksohet se: "Nuk ka asnjë dëshmi se vajza e veshur me shami përpiqet të krijojë shqetësime në përhapjen arsimit ose të përhape fenë. Prandaj, nuk është e drejtë që liria e fesë dhe të ndërgjegjes të kufizohet me ndalimin e shamisë".